

8 korrik 2014

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Willem Brouwer si kryetar i kolegjit, Gjyqtari i EULEX-it Timo Vuojolahti dhe Gjyqtari i Gjykatës Supreme Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtarja ligjore e EULEX-it Natalie Dawson duke vepruar në cilësi të procesmbajtëses.

Në lëndën penale kundër të pandehurit në vijim:

2K [REDACTED]

Lidhur me veprat penale:

1. **Krime të luftës kundre popullsisë civile sipas neneve 22 dhe 142 të KPRSFJ-së, dhe neneve 23 dhe 120 të KPK-së, atëherë në fuqi SEPSE:**
 - i. Më apo rreth 24 majit 1999 në cilësinë e gardianit në Burgun e [REDACTED], ka trajtuar të burgosurin [REDACTED] në mënyrë çnjerëzore duke i shkaktuar atij vuajtje të tepërta dhe cenim të integritetit trupor apo shëndetit duke e rrahur dhe duke e qëlluar me shkop gome deri në humbjen e vetëdijes dhe rrjedhimisht ka vdekur më 25 maj 1999;
 - ii. Më apo rreth 24 majit 1999 në cilësinë e gardianit në Burgun e [REDACTED] ka trajtuar të burgosurin [REDACTED] në mënyrë çnjerëzore duke i shkaktuar atij vuajtje të mëdha dhe cenim të integritetit trupor apo shëndetit duke e detyruar të kalojë përgjatë dy rreshtave me gardianë serbë të burgut, me police dhe me paramilitare ku bashkë me disa të burgosur të tjerë të pidentifikuar, janë rrahur dhe goditur me shkopinj gome, janë shkëmbuar dhe grushtuar nga i pandehuri dhe nga të tjerët.
2. **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328(2) i KPK se atëherë në fuqi, SEPSE në shtëpinë e tij në fshatin [REDACTED] Komuna e [REDACTED] ka mbajtur në posedim pa leje armën Zastava revolver si dhe dy karikatorë me municion.**

Duke vendosur në lidhje me dy Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të pandehurit KOLIC të paraqitura nga:

1. Avokati mbrojtës [REDACTED] më 3 maj 2014
2. Avokati mbrojtës [REDACTED] më 3 maj 2014

Duke pasur parasysh mendimin e Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës (PSHRK) të paraqitur më 21 qershor 2014

Pas këshillimit dhe votimit, sipas nenit 435 të KPP-se, Gjykata Supreme lëshon këtë:

AKTGJYKIM

25 **1. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokatët mbrojtës**

[REDAKTUAR] në emër të pandehurit [REDAKTUAR] më 8 maj 2014, refuzohen si të pabazuara.

2. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i datës 25 shtator 2013, vërtetohet.

I. Historia e procedurës:

- a. Më 1 gusht 2011, Prokurori Special ka ngritur aktakuzën.
- b. Më 26 gusht 2011, aktakuza është konfirmuar me anë të aktvendimit të gjyqtarit për konfirmim me numër KA. 538/2011, duke e ndryshuar njëzën nga pikat.
- c. Gjatë seancës për konfirmim i pandehuri K [REDAKTUAR] është deklaruar fajtor për akuzën e armëve.
- d. Pas shqyrtimit gjyqësor, është shpallur aktgjykimi nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 11 maj 2012. I pandehuri [REDAKTUAR] është shpallur fajtor për të dy veprat e Krimeve të luftës të listuara në aktakuzë dhe është dënuar me dënim unik prej 14 viteve burgim dhe me gjobë prej 500 euro. Trupi gjykues ka vazhduar paraburgimin derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.
- e. Më 25 shtator 2013, Gjykata e Apelit pjesërisht ka pranuar ankesat e paraqitura në emër të pandehurit [REDAKTUAR] dhe ka ndryshuar aktgjykimin e trupit gjykues. Ndryshimi është bërë në Dispozitiv, duke i bashkuar dy veprat penale në një pasi që kolegji ka gjetur se kanë të bëjnë me një "ngjarje dhe një grup të rrethanave" (në paragrafin 39 të aktgjykimit të saj).
- f. Më 8 maj 2014, dy avokatët mbrojtës kanë paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të pandehurit, dhe i pandehuri vetë ka paraqitur kërkesën e tij.
- g. Me 24 qershor 2014, Prokurori i Shtetit ka paraqitur mendimin.

II. Qëndrimet e palëve

Mbrojtja

- a. Është paraqitur një numër i arsyeve nga avokatët mbrojtës dhe vetë i pandehuri në lidhje me provat e dëgjura nga trupi gjykues, dhe të lexuara nga kolegji i apelit, të cilat kanë të bëjnë vetëm me vlerësimin faktik të lëndës.
- b. Provat nuk cilësohen si krime të luftës.
- c. Nuk ka pasur prova për bashkëkryerje.
- d. Aktgjykimi është bazuar në prova të papranueshme.
- e. Gjykata e shkallës së parë ka tejkaluar aktakuzën.

Prokurori

Parashtresat e mbrojtjes janë të pabazuara. Kërkesat duhet të refuzohen.

III. Gjetjet e gjykatës:

- a. Gjykata Supreme konsideron se të tri kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë paraqitur me kohë dhe janë të pranueshme.
- b. Kolegji ka vendosur të shqyrtojë të tri kërkesat e paraqitura për mbrojtje të ligjshmërisë, sipas nenit 19 (1.28) të KPP-së.
- c. Kolegji ka shqyrtuar me kujdes përmbajtjen e secilës kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë si dhe të aktgjykimeve të trupit gjykues dhe Gjykatës së Apelit.
- d. Kolegji konsideron se përmbajtja e kërkesave kryesisht ka të bëjë me provat e lëndës dhe vlerësimet e bëra nga trupi gjykues dhe më vonë nga kolegji i apelit.
- e. Gjykata Supreme ia përkujton avokatëve mbrojtës dhe të pandehurit se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është mjet i jashtëzakonshëm juridik i cili është në dispozicion sipas nenit 432 të KPP-së vetëm në rrethanat në vazhdim: shkelje të ligjit penal, shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet tjera të dispozitave të procedurës penale nëse shkelja e tillë ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Neni 432, paragrafi 2, në mënyrë specifike thekson se mjeti i tillë nuk është në dispozicion mbi bazën e 'vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike'.
- f. Mbrojtja e ligjshmërisë nuk duhet të përdoret si metodë indirekte e ankesës së metutjeshme. Çdo kërkesë e tillë e paraqitur me këtë qëllim është keqpërdorim i këtij mjeti juridik. Duke qenë kështu, çdo parashtresë e bërë nga avokatët mbrojtës apo i pandehuri të cilat kanë të bëjnë vetëm me vërtetimin e gjendjes faktike nuk merren parasysh nga kolegji i Gjykatës Supreme.
- g. Prandaj, kolegji ka vendosur vëmendjen e tij në arsyt tjera të paraqitura nga mbrojtja. Në lidhje me këtë, kolegji nuk ka gjetur asnjë shkelje të ligjit penal apo ligjit të procedurës.
- h. Kolegji më tutje gjen se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përkitazi me këtë është i arsyetuar mirë, i detajuar dhe arrin në rezultat të drejtë. Kolegji pajtohet me ricalësimin e veprave në lidhje me çështjet e krimeve të luftës. Gjithashtu, kolegji nuk sheh asnjë arsye që të përsërisë gjetjet e Gjykatës së Apelit, duke thënë se në tërësi pajtohet me vlerësimin e bërë nga kolegji i apelit.
- i. Prandaj, kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë refuzohen si të pabazuara dhe aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, vërtetohen.

Bashkangjitur: Mendimi i ndarë i Gjyqtarit Timo Vuojolahti.


Kryetar i kolegjit:

Procesmbajtëse:

Willem Brouwer
Gjyqtar i EULEX-it

Natalie Dawson
Zyrtare ligjore e EULEX-it

Timo Vuojolahti
Gjyqtar i EULEX-it


KARTESINE E KOSOVES
TAQIMOSTI OTPR
Avdi Dinaj
Gjyqtar i Gjykatës Supreme
Ministeri i Autoritetit
Qytetarëve të Kosovës

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PML 125/2014
8 korrik 2014